



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E HIDROKARBUREVE

Nr. 5816 Prot.

Tiranë, më 22/07 /2021

Lënda: Njoftimi i Planit të Dëgjësave Publike për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) të projektit të Depozitave Nëntokësore të Gazit Natyror në Zonën e Dumresë.

Z. Arif Tafani
Kryetar i Bashkisë Belsh

Z. Kreshnik Hajdari
Kryetar i Bashkisë Kuçovë

Të Nderuar Kryetarë,

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë po asistohet nga programi WB20-ALB-ENE-01 për hartimin e projektit teknik të Depozitave Nëntokësore të Gazit Natyror në Zonën e Dumresë. Projekti po hartohet nga një konsortium kompanish të huaja (Egis/IPF9) në bashkëpunim dhe me ekspertë lokalë. Zhvillimi i këtij projekti avancohet më tej përgatitjet e Shqipërisë në sektorin e gazit dhe infrastrukturën përkatëse të tij.

Pjesë e projektit është dhe vlerësimi mjedisor dhe social (VNMS) dhe konsultimi i tij me komunitetin lokal. Konsultimi do të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore shqiptare siç përcaktohet në VKM nr.686 datë 29.07.2015, të ndryshuar, dhe VKM nr.247 datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore". Në VKM-të e sipërcituara, kërkohet edhe bashkëpunimin ndërmjet zhvilluesit të projektit dhe bashkive duke specifikuar rolet dhe detyrimet për të garantuar konsultimin me komunitetin lokal dhe publikun.

Konsulentit së bashku me MIE është duke organizuar fushatën e Dëgjësave Publike për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social të projektit, pjesë e procedurës rregullatore të VNMS-së. Gjatë Dëgjësave Publike do të prezantohen gjetjet e VNMS-së dhe masat e propozuara për zbutjen e ndikimeve mjedisore, sociale dhe në shëndet të projektit.

Zona e studiuar nga projekti shtrihet në Njësinë Administrative Grekan, Bashkia Belsh, dhe Njësinë Administrative Kozare, Bashkia Kuçovë. Për këtë qëllim do të vlerësonim mbështetjen tuaj për organizimin e Dëgjësave Publike të cilat në përmbushje të kërkesave ligjore do të zhvillohen në çdo Njësi Administrative (brenda territorit të Bashkisë suaj) që ndërpritet nga gjurma e projektit (gjurma e projektit gjendet bashkëlidhur kësaj shkrese).

Takimet e Dëgjesave Publike do të zhvillohen sipas programit të paraqitur në Tabelën e mëposhtme.

Bashkia	Njësia Administrative	Data	Ora	Vendi
Belsh	Grekan	9 shtator 2021	10:00	Zyrat e Njesisë Administrative
Kucove	Kozare	9 shtator 2021	13:00	Zyrat e Njesisë Administrative

Menjëherë pas kësaj letre, përfaqësuesi ynë dhe konsulenti i caktuar nga ekipi i IPF 9 do të ndërmarrë fushatën e njoftimit duke shpërndarë në çdo bashki materialet e nevojshme të dëgjesës të tilla si, njoftimet, kopjet e Përmbledhjes Jo-Teknike, Draft raportin VNMS etj. Njoftimi për zhvillimin e dëgjesës do të bëhet dhe në mediat kombëtare.

Duam të vemë në dukje se bashkëpunimi dhe mbështetja e bashkive në këtë proces është thelbësore dhe e rëndësishme për informimin e komuniteteve tuaja në lidhje me çështjet e tyre të interesit të tilla si, gjurma e planifikuar e projektit, ndikimet negative dhe pozitive të projektit etj.

Ne besojmë në bashkëpunimin tuaj për zhvillimin e projektit, si një sipërmarrje e rëndësishme infrastrukturore në fushën e energjisë për Shqipërinë dhe rajonin.

Detajet e kontakteve të koordinatoreve të procesit të Dëgjesave Publike janë si më poshtë:

Eral Trasja, përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Celular: 0676013109

Posta elektronike: Eral.Trasja@infrastruktura.gov.al

Klodian Aliu, koordinator i ekipit të konsulentit IPF9

Celular.: 069 7855398

Posta elektronike: klodian.aliu@emaconsulting.al

Ju faleminderit,

ZËVENDËSMINSTRIT

Ilir Bejtja

